REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 886/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.886/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenkovic - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik:"E-Tech"SH.P.K. - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me softuer për backup - ritender", me nr. të prok: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, më datë: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "E-Tech"SH.P.K. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me softuer për backup - ritender", me nr. të prok: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me softuer për backup - ritender", me nr. të prok: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "E-Tech"SH.P.K. - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "E-Tech"SH.P.K. - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 03.11.2020 me nr. 886/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me softuer për backup - ritender", me nr. të prok: 318-20-6112-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, duke pretenduar se:

- Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 66 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe

- Neni 39 dhe 45 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.11.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me garancion 3 vjeçar për të gjitha zgjidhjet (Hardware dhe Software). Garancioni duhet ofruar nga prodhuesi i pajisjeve ose distributori i autorizuar. OE bazuar në dokumentet e dorëzuara përmes sistemit të E-Prokurimit (03.MAF dhe garancioni nga prodhuesi; DELL Technologies - Deklarata e Garancionit; DELL Technologies – MAF; Veeam - MAF dhe Garancioni nga prodhuesi), ka plotësuar dëshmitë dokumentare të kërkuara ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ndërsa, lidhur me vlerësimin nga AK se këto dokumente nuk plotësojnë kërkesën dhe dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit, kjo nuk është në harmoni me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikës 39 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), ku kërkohet që AK duhet të dërgojë "Kërkesë

për sqarim të tenderit".

Meqenëse, sipas komisionit dokumentet e tilla nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes e tenderit, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i drejtë, është dashur që me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, të kërkohen sqarime shtesë nga OE dhe vlerësimi i ofertës mund të vendosej vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga AK dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 09.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:

Ju njoftojmë se AK/KPMM nuk pajtohet me raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues sepse OE "E-TECH" ka qene i obliguar të ofroj deklaratë me shkrim mbi garancion 3 vjeçar për të gjitha zgjidhjet (Hardware dhe Software) nga prodhuesi apo dileri i autorizuar, ndërsa OE ka ofruar një dokument që nuk e plotëson kërkesën dhe dëshminë e kërkuar në dosje të tenderit, andaj nga AK/KPMM është kualifikuar ofertë e papërgjegjshme.

Nëse i referoheni kërkesës dhe dëshmisë tek kapaciteti teknik dhe profesional, ofertuesit kanë qenë të obliguar të ofrojnë një deklaratë me shkrim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar ku ceken këto të dhëna minimale si: Titulli i aktivitetit të prokurimit, numrat e prokurimit, kohëzgjatja garancionit prej 3 vite për pajisjen që oferton, deklarata e lëshuar për ju si ofertues nga prodhuesi apo dileri i autorizuar, nënshkrimi dhe vula. Ne si AK/KPMM nuk kemi të drejtë të përcaktojmë anën formale të asnjë dokumenti qe lëshohet nga ndonjë prodhues apo diler i autorizuar sepse është politikë e tyre e brendshme, por elementet domosdoshme që kërkojmë në përmbajtën e dokumentit duhet të jenë në mënyrë që dokumenti në fjalë të jetë në pajim me kërkesën dhe dëshminë në dosje të tenderit.

AK/KPMM nuk ka vepruar në pajtim me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së kërkesë për sqarime të tenderit, për arsye se ka munguar deklarata me shkrim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar dhe në rast kërkese për sqarime shtesë dhe pranim të një deklarate me shkrim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar përmes OE, atëherë do ishte në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-së "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti

kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues". Në rast pranimit të deklaratës me shkrim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar do ishte ndryshim material i tenderit. Gjithashtu kërkesa dhe dëshmia e kërkuar në DT, nuk bën pjesë në listën e dokumenteve që mund të kërkohen nga Autoritetet Kontraktuese sipas Nenit 39 paragrafi 8 të RrUOPP-së. Kërkojmë nga PSH që të refuzojë raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues dhe të aprovoj vendimin e AK/KPMM për anulim të procedurës së prokurimit.

Operatori Ekonomik, nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me garancion 3 vjeçar për të gjitha zgjidhjet (Hardware dhe Software). Garancioni duhet ofruar nga prodhuesi i pajisjeve ose distributori i autorizuar. Ndërsa, OE bazuar në dokumentet e dorëzuara përmes sistemit të E-Prokurimit (03.MAF dhe garancioni nga prodhuesi; DELL Technologies - Deklarata e Garancionit; DELL Technologies – MAF; Veeam - MAF dhe Garancioni nga prodhuesi), ka plotësuar dëshmitë dokumentare të kërkuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Andaj, lidhur me vlerësimin nga AK se këto dokumente nuk plotësojnë kërkesën dhe dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit, kjo nuk është në harmoni me Nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikës 39 të Rregullës së Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), ku kërkohet që AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit".

Meqenëse, sipas komisionit dokumentet e tilla nuk e kanë plotësuar kërkesën e dosjes e tenderit, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i drejtë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se është dashur që me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, të kërkohen sqarime shtesë nga OE dhe vlerësimi i ofertës mund të vendosej vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga AK dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Andaj, obligohet AK që të bëjë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëherit duke vepruar edhe në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Goran Milenkovic

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

1x1 OE -"E-Tech"SH.P.K. – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.